



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0054399-1/25 dt. 11.09.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 41-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 11.09.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Hamdi Hasani, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Mentor Vinarci, Faruk Mujka, Naser Muja, Elidiana Budini Haziri Ekrem Sadiku, Armend Begu, Jeton Zeneli, Erscka Barani, Xhyljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Ardita Aliu, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Vesel Neziri.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës Z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Munguan: Egzon Hamza, Kushtrim Zeneli, Shkurta Shosholli Musa, Xhevrije Bahtiri Ademi dhe Gazmend Asllani.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit Znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja e Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 41-të të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje,

Para se të fillojmë me rendin e ditës, dua të theksoj se pika e gjashtë, që ka të bëjë me dorëheqjen e z. Hysen Muzliukaj nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, nuk është një pikë që kërkon miratim nga Kuvendi. Kjo dorëheqje është dhënë si informatë për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Gjithashtu, ju njoftojmë se, për shkak të mungesës së kohës nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk është mundur të përgatitet propozimi për ndryshimin e emrit të anëtarit të ardhshëm që do ta zëvendësojë z. Hysen Muzliukaj.

Atëherë po e hap për diskutimin.

Faruk Mujka: Unë kam obligim të them disa fjalë, si për rendin e ditës, ashtu edhe jashtë tij. Së pari, dua t'ju them se jam i pathyeshëm, i palodhshëm, i pa shantazhuar, i pa heshtur dhe i palëkundur, pavarësisht të gjitha ndërskamëzave dhe gropave që janë hapur dhe që, pas një kohe të shkurtër, do t'u bien atyre që i kanë hapur. Këto filma që janë bërë këto tri ditë e fundit mund t'i besojnë mediat e paguara, por jo populli që na njeh prej mbi pesëdhjetë vjetësh, qëllimi i vetëm është të largohet vëmendja nga katër vitet e mospunës, të cilat u quajtën kot dhe të gjenden fajtorët kujdestarë.

Sa i përket pikave të rendit të ditës, përsëri e keni vërtetuar se jeni të dashuruar me veten dhe aspak nuk ju intereson demokracia, bashkëpunimi apo respektimi i rregulloreve dhe afateve. Mbajtja e Komitetit për Politikë dhe Financa vetëm një ditë para seancës për dokumentin kryesor për vitin është nënçmim për të gjithë asamblastët dhe, përmes tyre, për të gjithë qytetarët e Mitrovicës. Realiteti është se ky buxhet nuk i takon Kuvendit Komunal, në këtë rast kryetarit, bazuar në procedurat e ndjekura, nga ana tjetër, nëse doni

të thoni se jeni arsimorë, siç pretendoni, atëherë do të duhej të kishit propozuar dhe vepruar si para këtyre viteve, Lejoni kryetarin e ri, pa paragjykuar se kush do të jetë, ta hartojë buxhetin. E njëjta vlen edhe për hartën zonale, e cila po sillet dy ditë para fillimit të fushatës, dhe unë s'kam pasur kohë ta shqyrtoj në detaje për të kuptuar nëse ka pasur dyshime, apo vetëm janë ruajtur interesat e miqve tuaj. Nga ana tjetër mungon një dokument që vitin e kaluar e shtynit me dëshirë të madhe, dhe tani do të mund ta kishit përfshirë: raportin e auditimit për vitin e kaluar, i cili është tejet negativ dhe i pa kualifikuar. I njëjti raport, me të njëjtën përmbajtje, është përsëritur edhe vitin e kaluar, por atëherë ishit kandidatë për kryeministër dhe arritët ta ndryshoni opinionin – për të cilin ju përgëzoj – mirëpo ai sukses ka qenë afatshkurtër, sepse të gjeturat janë përsëritur edhe këtë vit. Pika e katërt për subvencionet nuk është pikë që nuk nevojitet, por është pikë me peshë politike, sepse ju e dini se Kuvendi ka të ndaluar abstencionet. Ju i keni vendosur vetë subvencionet, dhe mirë që i pranoni, por e dini se kjo është e gjetur. Për çfarë interesoni që kjo të ndodhë, edhe duke ditur se vitin tjetër nuk do të jemi këtu? Kështu e lini dhe e trashëgoni këtë situatë. Si përfundim, propozoj që të largohen nga rendi i ditës pikat për buxhetin dhe hartën zonale, dhe në vend të tyre të futet pika për raportin e auditimit.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: I nderuar z. Mujka, lidhur me çështjet e thirrjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, dua të sqaroj se komiteti dhe Kuvendi janë thirrur në kohë. Ka pasur kohë të mjaftueshme që të shqyrtohen pikat, në përputhje me kërkesat ligjore dhe brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Sa i përket hartave zonale, të gjithë e dimë që kur një pikë vjen për rishqyrtim, ligji na jep një afat prej tridhjetë ditësh kalendarike për ta shqyrtuar në Kuvend. Për kujtesë, kjo seancë është thirrur pikërisht sot, sepse pasnesër na kalon afati ligjor për rishqyrtim. Në lidhje me raportin e auditimit, unë personalisht nga Kuvendi jam duke pritur planin e zbatimit të rekomandimeve, i cili është i detyrueshëm të shoqërohet me raportin. Sa të jetë gati, dhe nëse është gati brenda këtyre ditëve, ju premtoj se do të thërras një seancë të veçantë vetëm për këtë çështje. Për të mos ndodhur që të thërrasim seanca të veçanta për secilën pikë, është më mirë që brenda kësaj seance të kemi gati edhe buxhetin, pasi që afati për dorëzimin e tij ka qenë deri më 30 gusht. Po ashtu, hartën zonale kemi pasur afat ta rishqyrtojmë deri më 14 shtator, dhe sot keni para vetes të gjitha pikat e tjera. Dua të theksoj se nuk kemi kaluar asnjë pikë asnjë ditë nga afatet ligjore, qoftë për thirrjen e seancave, qoftë për rishqyrtimin e tyre.

Armend Begu: Dështa të propozoj diçka lidhur me pajisjet që i kemi në përdorim, domethënë laptopët. Në legjislaturën e kaluar kemi miratuar që këto pajisje t'u mbeten asamblistëve. Sa u përket legjislaturës së ardhshme, mendoj që Kuvendi i ardhshëm duhet ta miratojë këtë vendim që pajisjet të mbeten në pronësi të asamblistëve. Edhe pse mund të duket pak si konflikt interesi, pajisjet janë amortizuar dhe pothuajse të shfrytëzuara deri në maksimum, dhe nuk i duhen më askujt. Nëse i kthejmë, secili prej nesh mund të ketë dokumentacion, madje edhe materiale konfidenciale të ruajtura nëpër softuerë, të cilat mbeten aty. Prandaj, po propozoj që të na mbeten në përdorim këto pajisje.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Z. Begu, besoj se sot nuk është koha për këtë diskutim. Kjo temë mund të lihet për mandatin e ardhshëm, sepse deri atëherë, kur unë ta dorëzoj mandatin, nuk është çështje urgjente. Unë po flas për pajisjet që i kam në përdorim tani – për shembull, laptopin tim. Nëse doni sot, mund ta dorëzoj, por unë e kam në përdorim deri në momentin kur të bëhet thirrja për dorëzim. Atëherë do t'i dorëzojmë pajisjet, ku do të kontrollohen nga zyrtarët e IT-së. Besoj se ata, nëse pajisjet janë në gjendje të mirë, do të marrin një vendim të duhur.

Atëherë nëse nuk ka të lajmëruar të tjerë për diskutim jo atëherë po vazhdojmë me miratim të rendit të ditës, si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar mbledhjes të rregullt të Kuvendit të Komunës të dt. 28.04.2025
2. Draft-buxheti për vitin 2026 dhe vlerësimet për 2027 dhe 2028
3. Propozim-vendim për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025
4. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare
5. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025
6. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: (Të pranishëm në mbledhje 29 anëtarë), 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.
Kryesuesja e konstatoi të miratuar Rendin e ditës.

Pika 1

Rezultati i votimit: (Të pranishëm në mbledhje 29 anëtarë), 24 për, 0 kundër dhe 1 abstenime.
Procesverballi nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja hapi diskutimin.

Kryetari të Komunës, z. Bedri Hamza: Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj sinqerisht për punën dhe bashkëpunimin tonë gjatë këtyre katër viteve. Një gjë që jam i sigurt në fund të këtij mandati, duke pasur parasysh që unë nuk jam në garë dhe nuk do të jem më pjesë e Kuvendit dhe ekzekutivit në Komunën e Mitrovicës, është se pavarësisht pozitës apo opozitës, të gjithë që kemi qenë këtu, qofshim në Asamble apo në ekzekutiv kemi pasur qëllim të përbashkët: të bëjmë më të mirën për qytetin dhe qytetarët e Mitrovicës. Faleminderit asamblistëve të partive që kemi qenë në koalicion për korrektësinë, angazhimin dhe disiplinën. Një falënderim i veçantë shkon për grupet parlamentare të Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ka pasur momente kur jemi pajtuar dhe momente kur kemi pasur mendime të ndryshme, por kjo është demokracia, mirë që ekzistojnë më shumë parti politike, më qëndrime dhe votime të ndryshme. Edhe pse kemi pasur dallime rreth mënyrës së arritjes së qëllimit, qëllimi ka qenë i përbashkët: të bëjmë më mirë për Mitrovicën. Faleminderit për punën e legjislativit, që na ka mundësuar edhe neve në ekzekutiv të punojmë dhe të kryejmë detyrat tona. Sigurisht, gjithmonë ka vend për më mirë dhe për më shumë. Ju uroj suksese të gjithëve që jeni në garë, legjislativit të ardhshëm dhe ekzekutivit të ardhshëm, dhe do të gëzohem për çdo arritje të institucioneve të Komunës së Mitrovicës në dobi të qytetarëve tanë. Ka qenë kënaqësi të punoj me ju në një atmosferë pune, korrektësie dhe respekti reciprok. Një digresion i vogël: për mua është shumë i rëndësishëm dhe i respektueshëm prezumimi i pafajësisë. Duhet ta respektojmë Kushtetutën dhe ligjet tona, dhe prezumimi i pafajësisë duhet të respektohet nga të gjithë.

Sa i përket buxhetit, kërkesa ime ka qenë dhe është që ne si ekzekutiv ta përgatisim dhe procedojmë atë në kohë, dhe për këtë arsye kemi dorëzuar buxhetin në Sekretarinë e Kuvendit në përputhje me ligjin. Kërkesa ime është që të mos mbetet asnjë obligim i papërfshirë në buxhet, asnjë kontratë aktive apo detyrim i pa reflektuar financiarisht. Për vitin 2026, hapësira do të jetë më e vogël për shkak të projekteve në vazhdim, ndërsa për vitet 2027, 2028 dhe 2029 kam bërë përpjekje që të lë hapësirë për legjislativin dhe ekzekutivin e ardhshëm të vendosin prioritetet e tyre. Në buxhet janë të parashikuara fondet për bashkëfinancim, që lënë hapësirë për projekte të reja sipas prioriteteve të ardhshme. Mandati nuk ka qenë i lehtë, për shkak të detyrimeve të prapambetura mbi 13 milionë €, shumica e të cilave janë rezultat i kontratave kolektive në arsim, shëndetësi dhe fusha të tjera. Megjithatë, jemi ndër komunat e pakta ku nuk ka vendime përmbarimore për ekzekutim. Kontratat kolektive kanë qenë ngarkesë e madhe për kapacitetet financiare të komunës, dhe kanë ndikuar në planifikimin e projekteve, duke penguar fillimin e disa prej tyre. Përveç kësaj, ato janë një nga arsyet kryesore për kualifikimin e raportit të auditimit, për shkak të keqklasifikimit, pasi pagat janë paguar përmes urdhrave përmbarimore, që në fakt janë pjesë e kontratave kolektive. Sa i përket projekteve kapitale, ato janë buxhetuar dhe planifikuar sipas kërkesave të Ministrisë së Financave, duke përfshirë numrin e punësuarve, pagat, mëditjet, mallrat, shërbimet, subvencionet, shpenzimet komunale dhe investimet kapitale.

Trendi i të hyrave këtë vit është i mirë, dhe pres përmbushje të plotë të planit, me mundësi edhe tejkalimi. Një pjesë e të hyrave vetanake do të bartet në vitin e ardhshëm dhe do të përdoret sipas vlerësimit të ekzekutivit dhe legjislativit të ardhshëm. Sa i përket punëve të kryera, sipas institucioneve që ndjekin punën e Kuvendit, nga 123 premtime, 72 janë realizuar, 14 janë gjysmë përmbushura dhe 14 të tjera janë në fillim të zbatimit. Kjo tregon se jemi komuna me më së shumti punë të kryera, gjysmë përfunduara dhe të filluara ndër komunat e mëdha.

Në fund, ju uroj suksese të gjithëve që jeni në garë, pa dallim politik. Faleminderit shumë për bashkëpunimin dhe rrugëtimin tonë të përbashkët. Përmbyllja, më kujtohet kur është renovuar kjo sallë dhe unë kam qenë asamblist për herë të parë, kur Grupi ynë i Asamblistëve ka filluar angazhimin në Mitrovicë. Me përfundimin e mandatit tim si kryetar, pasi të kem një periudhë pushimi, nuk do të kem më angazhim institucional apo publik. Ju dëshiroj suksese dhe besoj që progresi do të vazhdojë. Faleminderit kryesueses

për udhëheqjen e shkëlqyer të seancave dhe për komunikimin e mirë me të gjitha grupet parlamentare. Faleminderit edhe asamblistëve të opozitës për kontributin profesional dhe gjuhën e zgjedhur në debat. Ju falënderoj shumë, dhe suksese juve që jeni në garë!

Nafije Rexha: Të nderuar kabinet qeverisës, zonja kryesuese dhe kologë asamblistë, Faleminderit për bashkëpunimin dhe përpjekjet gjatë këtyre katër viteve. Ky është mandati im i dytë dhe nga fillimi deri tani jam ndjerë e respektuar dhe e qetë në këtë Kuvend. Kryetari Bedri Hamza na dha shembull të qeverisjes së mirë, si në nivel komunal, ashtu edhe qendror. I bëj thirrje qytetarëve të vlerësojnë punën me mend dhe zemër, duke menduar për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Unë vij nga arsimi, ku kam punuar mbi 35 vite duke edukuar brezat për respekt ndaj atdheut, familjes dhe shtetit. Faleminderit kryetarit për rezultatet e arritura në Mitrovicë, të cilat janë vlerësuar edhe nga Instituti GAP. Shpresoj që edhe e ardhmja të vijë me sukses të ngjashëm, pavarësisht nga kush drejton, dhe se modeli i punës së mirë do të vazhdojë për brezat e rinj. Modeli i mirë nuk harrohet kurrë.

Elidiana Budini Haziri: Për dy vite kemi miratuar buxhet për dy shkolla të mëdha, shkollën ekonomike dhe gjimnazin – por nuk është investuar pothuajse asgjë, arsimi është prioritet i madh dhe duhet përmirësuar urgjentisht, përfshirë rikonstruktimin dhe furnizimin me mjete si tabela digjitale. Kam dy kërkesa për buxhetin: Së pari, punësimi i një personi në zyrën për komunitete për përfaqësim më të mirë dhe fonde më të mëdha. Së dyti, riparim i mini-parkut pranë çerdhes dhe lagjes së Desit, që është shkatërruar dhe fëmijët kanë nevojë për hapësirë të sigurt për lojë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Faleminderit për diskutimin dhe propozimet. Më vjen keq që nuk kemi arritur të rinovojmë gjimnazin dhe shkollën e muzikës, pavarësisht fondeve dhe përpjekjeve. Procedurat dhe vonesat burokratike na kanë penguar. Megjithatë, nuk është e vërtetë që nuk është bërë asgjë në arsim. Janë investuar shkolla të tjera si Elena Gjika, Eqrem Çabej, Skënderbeu, Migjeni dhe të tjera, në përputhje me kapacitetet financiare të komunës dhe në bashkëpunim me nivelin qendror. Renovimi i çerdhes dhe investimet në shkolla teknike po vazhdojnë. E kuptoj kritikën dhe jam i gatshëm të bashkëpunoj për përmirësim, por duhet të jemi realistë për atë që është bërë dhe mund të bëhet.

Fadil Veseli: Do jem i shkurtër. Buxheti për vitin e ardhshëm në Mitrovicë parashikon rreth 32 milionë €. Nga kjo shumë, mbi 55% shkojnë për paga dhe mëditje, që janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen. Për mallra dhe shërbime shpenzohen 15% të buxhetit, që janë gjithashtu fiks. Kështu, investimet kapitale janë rreth 7.7 milionë €, por pjesa e lirë për projekte të reja është afërsisht 5 milionë. Kërkesat janë shumë dhe të arsyeshme, por mjetet janë të kufizuara, ndaj duhet bërë përzgjedhje dhe prioritet. Për shembull, arsimi ka grant specifik prej 11.5 milionë € dhe shëndetësia 3.6 milionë. Në të kaluarën, disa projekte u kryen pa mbulesë financiare dhe janë bartur në vitin tjetër, gjë që e ka vështirësuar situatën. Ky buxhet ka një nivel minimal të detyrimeve të bartura, që e bën të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm. Prandaj, mendoj se ia vlen të votohet, duke pasur kujdes me prioritetet dhe kapacitetet financiare.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Ju lus ta aprovoni buxhetin sepse është obligim ligjor që Kuvendi ta miratojë deri më 30 shtator dhe ta dërgojë në Ministrinë e Financave. Aktualisht në vend nuk janë formuar organet dhe Qeveria, dhe nëse kjo nuk ndodh, mund të kemi zgjedhje pa buxhet të aprovuar. Në këtë rast, Qeveria është e detyruar ta procedojë buxhetin në Kuvend deri më 31 tetor, por aktualisht nuk ka kush ta procedojë. Nëse ndodh kjo situatë, Komuna e Mitrovicës do përballet me sfida më të mëdha se komuna e Prishtinës, e cila vitin e kaluar nuk miratoi buxhetin në kohë dhe pati probleme me financat. Prandaj, ju kërkoj mirëkuptim dhe bashkëpunim. Kam lënë një shumë të konsiderueshme pa projekt specifik, që mund të përdoret më vonë për ndryshime apo prioritet të reja. Kushdo që vjen në pushtet ka rrugë ligjore për ndryshime dhe plotësime. Buxheti duhet të miratohet tani për të garantuar funksionimin e komunës.

Naser Muja: Dua të lidhem shkurt me draft-buxhetin. Rreth 70% e projekteve janë vazhdimësi të atyre të mëparshmeve. Më intereson të di nëse obligimet financiare do të mbesin për qeverisjen e ardhshme dhe sa do të jenë ato. Faturat e këtij viti do përfundojnë, por nëse obligimet mbeten për vitin tjetër, a do i bart qeverisja e ardhshme? Sepse kontratat që kemi tani me siguri përfundojnë këtë vit, por obligimet përfundimtare mund të kalojnë më tej. Nëse mund, kryetari të na tregojë se sa nga këto projekte, sidomos ato me vlerë mbi dy milionë €, do të mbeten si obligime për vitin tjetër. Përndryshe, do na mbeten borxhe të mëdha si më parë, që përfshijnë faturat e dorëzuara por të paguara më vonë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Mjetet financiare janë të ndara nëpër kode projektesh. Unë kërkoj nga ekzekutivi dhe përgjegjësit që faturat të pranohen dhe paguhen në kohë, pa vonesa, kur plotësohen

kushtet ligjore. Punët e kryera gjatë këtij viti nuk duhet të bartën obligime për vitin e ardhshëm. Për projektet mëvjeçare që nuk përfundojnë në këtë vit, pagesat janë të mbuluara në buxhetin e vitit të ardhshëm, prandaj punët e kryera duhet të paguhen sipas ligjit dhe logjikës, përveç rasteve kur puna bëhet në dhjetor, ku mund të ketë vonesa të arsyeshme. Në përputhje me kapacitetet financiare, pagesat duhet të realizohen pa vonesa, por gjithmonë do të ketë dallim mes nevojave dhe mundësive financiare. Kështu është dizajnuar buxheti dhe pres që të ekzekutohet në këtë mënyrë.

Armend Begu: u filluat me disa suksese të qeverisjes së re katërvjeçare, që është normale. Pastaj përmendët disa mosrealizime, që edhe ato janë të pritshme. Për shembull, në fushatën zgjedhore premtuat ndërtimin e një objekti për Shoqatën e Shurdhmecëve, ku duhej të riparohej çatia dhe të ndërtohej objekti ekzistues, por as çatia nuk është rregulluar dhe as objekti nuk është ndërtuar. Një tjetër mosrealizim është rruga "Ali Zeneli", ku projekti parashikonte edhe gjelbërim, por u betonizua vetëm dhe nuk u përfundua siç duhet. Prania e madhe e mbeturinave në qytet nuk është vetëm përgjegjësi e qeverisjes, por edhe e qytetarëve që i hedhin jashtë vendit. Problemi me trajtimin e qenve në Endacak vazhdon, edhe pse kërkesat për menaxhim janë bërë vazhdimisht dhe janë ndarë mjete, problemi mbetet i pazgjidhur. Për rrugën Zhashë Vllahi, komuna ka marrë vendim për rregullim, por rruga është shumë e ngushtë dhe e rrezikshme. A ka plane për ta zgjeruar ose për rrugicat në fshatin Vllahi? Sa i përket borxheve, është thënë që kanë mbetur 10 milionë €, ndërsa kanë paguar 13 milionë. A ka statistika të qarta për borxhet që mbeten, që ekzekutivi i ardhshëm të mos ketë pengesa?

Kryetari i Komunës z.Bedri Hamza Problemi me qenët vendacakë është bërë shumë i madh, jo vetëm për Mitrovicën, por për gjithë Kosovën. Ne kemi pasur një kontratë dhe rregulla që duhet të respektohen, por çështja nuk është finalizuar ende. Këta qen janë shumë agresivë dhe shpresoj që procedurat e prokurimit të përfundojnë shpejt dhe të adresohen këto probleme. Mjetet për këtë janë në buxhet, dhe kontrata është në proces. Sa i përket ndërtimit të rrugëve në fshatra, përveç kodeve specifike për zona të caktuara, kemi edhe një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës. Një pjesë e madhe e financimit vjen nga niveli qendror, dhe shpresoj që kjo kontratë, me vlerë rreth tre milionë €, të përfundojë dhe rrugët të rregullohen sipas standardeve.

Erseka Barani: Dua të flas shkurt për draft-buxhetin. Gjatë këtyre katër viteve kemi kërkuar shtim projektesh dhe realizimin e tyre, por për disa kemi hasur vesh të shurdhër. Kam kërkuar disa herë shtim të subvencioneve për Shëndetësinë, sidomos për digjitalizimin e diagnostikës, por nuk është realizuar. Objektet janë të reja, por mbetemi peng i procedurave burokratike dhe mungesës së ndriçimit, edhe në qendër, e jo më në fshatra. Në draft janë planifikuar rreth 126.000 € për këtë, por mendoj se është shumë pak për të mbuluar nevojat. Renovimi i qendrave të mjekësisë familjare është bërë, por pa mjekë dhe barna esenciale, shërbimi është i pamundur, një qendër pa mjek është e pavlefshme. Drafti është 80% identik me vitet paraprake dhe shumë i vështirë për realizim. Po ashtu, cilësia e rrugëve të shtruara lë për të dëshiruar, si p.sh. Rruga "Ukshin Kovaçica" që është në gjendje të keqe. Nuk ka hapësira gjelbëruese dhe menaxhimi i qenve endacakë mbetet problem i madh. Për këto arsye, buxheti për mua është fiktiv dhe nuk do ta votoj.

Florina Çitaku: Sot para nesh është një dokument jo vetëm financiar, por një nga vendimmarrjet më të rëndësishme të vitit dhe një premtim për të ardhmen e komunës sonë. Ky buxhet dëshmon se me përgjegjësi dhe vizion mund të sigurojmë më shumë investime, shërbime dhe zhvillim për të gjithë. Ai fokusohet në rrugë më të mira, shkolla më të pajisura, mbështetje për të rinjtë, gratë dhe bizneset, duke kthyer taksat e qytetarëve në punë konkrete në çdo lagje dhe fshat. Jam krenarë që jam pjesë e këtij procesi, që shpreh punën tonë të përbashkët dhe hap një rrugë drejt një komune më moderne, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Ju ftoj të gjithë kolegët të mbështesim këtë buxhet dhe të ecim përpara me besim se vitin e ardhshëm qytetarët tanë do të kenë edhe më shumë arsye për krenari.

Flutura Beka Kamberaj: Sot jemi mbledhur në seancën e Kuvendit të Komunës, që njëkohësisht është edhe mbledhja e fundit e këtij mandati. Ky është një moment i veçantë për të reflektuar mbi rrugëtimin tonë të përbashkët dhe për të falënderuar qytetarët, të cilët na besuan mundësinë për të kontribuar në zhvillimin e qytetit tonë. Një nga pikat kryesore të rendit të ditës është miratimi i draft-buxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. Ky buxhet nuk është thjesht një dokument financiar, por një plan vizioni për zhvillimin e komunës, investime në infrastrukturë, përmirësimin e shërbimeve publike, mbështetjen e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe organizatave joqeveritare që kontribuojnë në jetën shoqërore të qytetit. Qëndrimi ynë për buxhetin për vitin 2026-2028 është i qartë: Ne jemi për një qasje pozitive që reflekton interesat e qytetarëve. Si LDK, do të vazhdojmë të kërkojmë që proceset buxhetore të jenë funksionale,

transparente dhe në kohë, në shërbim të zhvillimit të komunës. Gjatë këtij mandati, edhe në rolin e opozitës, LDK-ja ka kontribuar me qasje konstruktive dhe propozime konkrete, duke treguar se opozita nuk është pengesë, por një partner kritik dhe pozitiv për një qeverisje sa më të mirë dhe transparente. Në emër timin personal dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, shpreh mirënjohjen më të thellë për qytetarët për durimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë këtij mandati. Angazhimi ynë do të vazhdojë, sepse Mitrovica meriton vizion, zhvillim dhe një të ardhme më të mirë. Po ashtu, uroj suksese të gjithë kandidatëve për Asamble Komunale dhe Kryetar Komune në zgjedhjet e ardhshme. I.e të kemi të qartë se pozita e asambleistit dhe kryetarit nuk është vetëm një pozitë politike, por një përgjegjësi e madhe ndaj qytetarëve. Çdo vendim dhe veprim ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e komunitetit dhe familjeve tona, ndaj kërkohet përkushtim maksimal, transparencë dhe vizion afatgjatë.

Veseli Neziri: Sot diskutojmë buxhetin e qytetit tonë, një nga pikat më të rëndësishme për zhvillimin e komunës. Edhe pse ky buxhet mund të jetë më i mirë dhe më efikas, ai është ai që kemi dhe duhet ta mbështesim. Jemi në një situatë të vështirë, ku muaji mars mund të sjellë paqartësi për komunën dhe të gjitha komunat e Kosovës nëse institucionet qendrore nuk konsolidohen. Ky buxhet garanton financimin për projektet dhe përmbush obligimet kontraktuale. Megjithatë mund të ketë disa mangësi, buxheti përmban projekte konkrete dhe të mbuluara financiarisht. Nuk kam parë ndonjë projekt që duhet larguar. Dua të përmend edhe deklaratat e kryetarit në fillim të mandatit, që shumë nuk u besuan, por ai nuk la politikën dhe nuk e la komunën pa udhëhoqje. I uroj suksese në rrugëtimin e tij dhe shpresoj që do të përfundojë obligimet e mbetura nga mandati i kaluar. Në përfundim, dëshiroj që ky buxhet të jetë buxhet shprese dhe sigurie për të ardhmen tonë.

Xhyljeta Imeri: Faleminderit për përgatitjen e draft-buxhetit për vitin 2026. Dëshiroj të ndalem tek investimet kapitale, veçanërisht për ndriçimin publik. Kërkoj që në çdo lagje dhe fshat të qytetit të sigurohet ndriçim publik, duke përfshirë rrugët "Istref Salihu" në Kushtovë, "Eqem Çabej" në Shipol dhe "Hoxhë Hasan Tasini". Këto janë zona me banim të dendur dhe ndriçimi publik është thelbësor për sigurinë e fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve. Gjithashtu, kërkoj që në rrugën "Muhaxhiret" në Shipol të bëhet ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit, që kanë shkaktuar probleme të vazhdueshme. Në kodin për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, kërkoj të planifikohen mjete shtesë për këtë qëllim. Nga drejtoria e arsimit, kërkoj vendosjen e psikologëve dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe përfshirjen e shkollave fillore në programin për kabinete. Duhet të sigurohen tabela digjitale për të gjitha shkollat dhe të ndahen mjete për zgjerimin e shkollës Aziz Sylejmani në Suhodoll. Nga Drejtoria e Urbanizmit kërkoj që lejet e ndërtimit të lëshohen vetëm pasi të sigurohen hapësira të gjelbra, vende të përshtatshme për fëmijë dhe të moshuar, si dhe parkingje të mjaftueshme për banorët. Kontrolli teknik duhet të refuzojë lejet në mungesë të këtyre elementeve dhe të mos lejojë ndryshime në lokale që dëmtojnë hapësirat publike. Nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit kërkoj zbatim rigoroz të planit për hapësira të gjelbra. Nga Drejtoria e Shëndetësisë, në QKMF, tek Departamenti i Stomatologjisë, kërkoj krijimin e një këndi lojërash për fëmijë me karrige dhe ngjyra tërheqëse, për të bërë vizitat më miqësore dhe kreative. Në fund, falënderoj qytetarët e Mitrovicës, Kryetarin, Kryesuesen, drejtorët, kolegët, anëtarët e Kuvendit dhe sekretarinë për bashkëpunimin e mirë. Ju dëshiroj shëndet dhe suksese.

Ekrem Sadiku: I nderuari kryetar, Më kujtohet viti i parë i mandatit tuaj kur diskutuam draft-buxhetin dhe secili prej nesh solli propozime, shumica për të mirën e qytetarëve të Mitrovicës. Ju na premtuat atëherë se buxhetin do ta hartonim bashkë, pozitë e opozitë, por kjo nuk u realizua. Përvojë disa projekteve të vogla, shumica e tyre nuk u përfunduan, përfshirë rrugën "Ali Zeneli" dhe projektin "Lah Nimani". Një aspekt pozitiv është renovimi i shkollave, i cili duhet të bëhet rutinë, pasi është domosdoshmëri për mirëmbajtjen e tyre. Por shqetësues mbetet fakti se buxheti i këtyre katër viteve ka qenë i njëjtë në përbërje dhe përqindje, me vetëm disa ndryshime minimale dhe projekte të vogla. Kërkesat tona dhe të komuniteteve, si kryetarët e lagjeve dhe fshatrave, nuk janë dëgjuar asnjëherë. Një gabim tjetër është procedimi i buxhetit shumë vonë, vetëm një ditë para seancës, duke na privuar nga diskutimi i detajuar. Ju kujtoj që jemi dakorduar se pjesa kryesore e buxhetit do të mbetet për legjislaturën e re, por edhe kjo nuk u respektua. Kërkesat tona dhe vendimet e marra në Kuvend nuk janë zbatuar, veçanërisht në arsimin tonë. Shembuj janë mungesa e funksionimit të shkollave, mos subvencionimi i kategorive deficitare në shkollat teknike, mos përfshirja e psikologëve dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe mungesa e mësimdhënësve për mësimin në gjuhën shqipe. Problemet infrastrukturore vazhdojnë të jenë të mëdha, si rruga Bare në lagjen Xhafa, e cila është riparuar por shpejt u dëmtua dhe është e pakalueshme. Kjo është një problem që është

ankuar disa herë, por nuk ka zgjidhje. Prandaj, për këto arsye, nuk do të votoj këtë buxhet. Mendoj se duhet t'i lihet legjislaturës së re ta procedojë me kujdes.

Drita Kadriu: Dëshiroj t'ju plotësoj informacionin, pasi qëndrimi juaj është paksa njëanshëm dhe politik. Ne kemi përpjekur të mos politizojmë arsimin. Për dy vite kemi punuar me platformën e-shkollori, por për shkak të ndërprerjes së negociatave të Ministrisë së Arsimit me operatorin, funksionalizimi i saj është ndërprerë në të gjitha komunat. Megjithatë, besoj që ministria aktuale ose e ardhshme do ta funksionalizojë këtë platformë për mbledhjen e të dhënave në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, ndryshimet në rregullore dhe legjislacionin për rekrutimin e stafit shkaktuan vështirësi organizative. Nuk kemi situata si në vitin 2022, kur në raportin e auditimit ishin identifikuar 61 mësimdhënës që punuan pa paga me kontrata të paplota. Sot, për konkurset përgjigjet Zyra e Burimeve Njerëzore sipas legjislacionit, jo Drejtoria e Arsimit.

Faruk Mujka: Nuk dua të zgjatem, por ndjej obligim me e thënë hapur: për katër vjet, kemi kërkuar bashkëpunim, kemi kërkuar raporte nga drejtorët, por jemi injoruar pothuajse plotësisht. Kjo arrogancë e pushtetit e ka sjellë këtë situatë ku nuk ka më as komunikim, as besim. Këtu sot po na thuhet që po japim komente të njëanshme – por nuk është faji ynë nëse nuk na është dhënë mundësia për t'u dëgjuar. Në katër vite, shumë herë kemi kërkuar informacione, ballafaqim dhe raporte, por asnjëherë nuk kemi pasur prezencë apo përgjigje serioze nga drejtuesit, veç kur u dashtë të mbrohen. Sa i përket arsimit – po, është politizuar rëndë. Konkursët për drejtorë janë bërë me kritere partiake, dhe madje ata që janë shpallur të paafët, më pas janë bërë ushtrues detyre. Ku është plani i arsimit? Ku janë raportet? Asgjë s'është bërë. Po flitet për borxhe? Mbi 10 milionë € janë propaganduar si borxhe, por faktikisht, sipas dokumenteve zyrtare, janë vetëm rreth 2.1 milionë € borxh real. Dhe pjesa më e madhe e atyre borxheve vijnë nga obligime të nivelit qendror, përfshirë kontratat kolektive dhe stafin arsimor, që janë përgjegjësi e qeverisë. Sa i përket GAP-it – nuk është referencë e besueshme. Në një raport e kanë përmendur ashensorin në Komunë që as nuk ekziston, dhe që s'ka lidhje me financat e komunës. Sa për projektet, shumë prej tyre janë të njëjtat që po përsëriten prej vitesh në buxhet dhe nuk realizohen. Shumë rrugë janë nisur pa projekte të qarta, nuk ka pranime teknike, dhe investimet në gjelbërim janë kthyer në beton. E theksoj: ky është një buxhet reprizë, një fotokopje e viteve të kaluara. Në fund, na thuhet "votojeni për të mirën e qytetarëve". Por na është sjellë një ditë para, pa konsultim, pa proces të hapur. E çfarë bashkëpunimi është ky? Prandaj, për hir të korrektësisë, për hir të qytetarëve, e them hapur: nuk do ta votojmë këtë buxhet, sepse është i njëanshëm, i mbyllur dhe nuk përfaqëson asnjë prej kërkesave të komuniteteve që përfaqësojmë.

Pas prezencës së verifikuar të 27 anëtarëve të Asamblesë Komunale, është kaluar në procesin e votimit:

Rezultati i votimit: 21 për, 5 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e Kuvendit konstatoi se miratohet Buxheti për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028.

Pika 3

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Propozim-vendim për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit të Komunës datë 28 prill 2025, Bëhet fjalë për rishqyrtimin e pikës së hartave zonale, për shkak të përmirësimeve të nevojshme në vitet e përmendura në propozim-vendim dhe në vendimin përfundimtar të dokumentit. Ky rishqyrtim ka ardhur për të plotësuar dhe përmirësuar vitet e caktuara në dokumentacion, pas diskutimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Dokumenti i përditësuar është shpërndarë tek të gjithë anëtarët me materialin përkatës. Nëse ka ndonjë koment ose pyetje, drejtorët mund të ndërhyjnë për diskutime.

Në fund, pas diskutimeve, do të vazhdojmë me votimin e këtij propozim-vendimi, hap diskutimin.

Faruk Mujka: Të lutem, a mund të lëmë këtë pikë për më vonë, pas disa pikave të tjera që i kemi me miqtë tanë më përpara? Na duhet me vazhdu ashtu siç e kemi fillu, sepse dëshirojmë të jemi pjesë e votimit në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Shumica e anëtarëve të LVV lëshuan mbledhjen.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Po vazhdojmë, dhe nëse nuk ka diskutime, konstatoj se prezent kemi njëzet e dy asamblistë, pra kuorumi ekziston. Po vazhdojmë me procesin e votimit. Kush është për miratimin e propozim-vendimit për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit të Komunës, sipas kërkesës për rishqyrtim nga Ministria?

Rezultati i votimit: (Të pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 18 për, 0 kundër dhe 1 abstenime.

Kryesuesja e Kuvendit e konstatoi të miratuar vendimin për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025.

Pika 4

Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare. Me material kanë ardhur katër kërkesa. Në Komitetin për Politikë dhe Financa ka ardhur edhe një kërkesë tjetër, duke u bërë gjithsej pesë kërkesa. Për këtë kërkesë të pestë, unë kam diskutuar me shoqatën në fjalë dhe më janë lutur që për shkak se thirrja në Drejtorinë e Mirëqenies nuk është hapur, të subvencionohen edhe ata me 500 €. Pra, po ju propozoj që kjo kërkesë t'i bashkëngjitet katër kërkesave të tjera për subvencionim prej 500 €sh për secilën nga shoqatat në fjalë. Shoqatat që kanë kërkuar përkrahje janë: Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e veteranëve, Organizata e veteranëve të luftës, Zëri i prindërv dhe Doën-Syndrome Kosova. Pesë prej këtyre shoqatave kërkojnë subvencion prej 500 €sh për funksionimin e tyre gjatë vitit, dhe kjo është diskutuar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Nëse dikush dëshiron të bëjë ndonjë koment apo diskutim, mund ta bëjë tani. Në rast se nuk ka, duhet të kalojmë në votim për secilën organizatë veç e veç. Unë propozoj të fillojmë votimin me kërkesën e parë.

Kush është që të subvencionohet me shumën prej 500 € Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së?

Rezultati i votimit: (Të pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet kjo kërkesë miratohet.

Kush është që të subvencionohet me 500 € Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së?

Rezultati i votimit: (Të pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se kërkesë miratohet.

Kush është që të subvencionohet me 500 € Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së?

Rezultati i votimit: (Të Pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet kjo kërkesë miratohet.

Kush është që të subvencionohet me 500 € OJQ "Zëri i Prindërve"?

Rezultati i votimit: (Të pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

(Të Pranishëm 21 anëtar të kuvendit)

Kush është që të subvencionohet me 500 € shoqata "Down Syndrome Kosova" – Dega në Mitrovicë?

Rezultati i votimit: (Të Pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se edhe kjo kërkesë miratohet.

Pika 5

Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, Raporti Financiar për periudhën janar-qershor 2025, i cili nuk u trajtua në seancën e fundit. Kush është për miratimin e këtij raporti?

Rezultati i votimit: (Të pranishëm 21 anëtar të kuvendit) 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e kuvendit e konstatoi të miratuar Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025.

Pika 6

Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:09 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA